

## Terminologji gjuhësore

# Mbi aktantët obligativë dhe fakultativë

Agim Spahiu

20 tetor 2001

### Përmbledhje

Në këtë artikull autori ka prekur një çështje gjuhësore që fare pak ose aspak nuk është trajtuar në gjuhësinë shqiptare. Fjala është për AKTANTËT si term dhe kategori gjuhësore e gramatikës dependenciale.

Termi **aktant** nuk përmendet në gramatikat tradicionale dhe në ato të gjuhës së sotme shqipe. Rrallëherë e gjejmë të përdorur në ndonjë fjalor, tekst të gjuhësisë ose në ndonjë studim që ka të bëjë përgjithësisht me çështje gjuhësore. Por në të shumtën e rasteve ato shënime janë të pakta e të përcipta, nuk zihet ngojë çështja e llojllojshmërisë së tyre etj. Dhe për këtë arsye te lexuesi i vëmendshëm menjëherë krijohet përshtypja se ato janë bërë vetëm sa për ta shkuar radhën dhe asgjë tjetër. Prandaj kësaj radhe e pamë të arsyeshme t'i kushtojmë këtij termi gjuhësor, duke u ndalur kryesisht në burimësinë dhe kuptimet më themelore të tij. Do të përpiqemi t'i vëmë në pah pikat më kryesore të këtij termi. Por gjithashtu jemi të vetëdijshëm se në një shkrim të kësaj natyre vështirë se mund të thuhet të gjitha.

I pari që e përdori këtë term, është gjuhëtari i njohur frëng **L. Teniere** (L. Tesniere, 1893 - 1954) në studimet e tij, e sidomos në **Elements de syntaxe structurale**, (botuar në Paris më 1959). Nga vetë emërtimi i këtij studimi mund të vëmë re se ky term dhe e gjithë problematika janë vështuar me anë të metodës strukturaliste.

L. Teniere në këtë vepër monumentale ka bërë një krahasim shumë interesant: I krahason gjymtyrët e njësive sintaksore me aktorët e një shfaqjeje teatrore. Sipas tij, në një shfaqje teatrore, në një dramë, luajnë aktorët a personazhet e dorës së parë (les personnages principaux) dhe ata të dorës së dytë (les personnages secondaires de l'action). Për analogji me këtë, në gjuhësi mbizotërojnë *aktantët emërorë* dhe *rrethorët* (circumstants). *Aktantët* kanë këtë shkallëzim: Aktanti i parë është subjekti; i dyti është kundrina e drejtë (complement d'objet); i treti është kundrina e zhdrejtë (complement indirect) e kështu me radhë<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup>Shih: L. Tesniere, *Grundzüge der strukturalen Syntax*, Stuttgart, 1980, f. 100 - 101; Pastaj: O. Ducrot § J. M. Schaeffer, *Nouveau dictionnaire encyclopedique des sciences du langage*, Editions du Seuil, 1995, f. 449 - 455; H. Pelz, *Linguistik, Eine Einführung*, Hamburg, 1999, f. 158; etj.

Në teorinë e tij gjuhësore, sikundër dihet, **folja** është konsideruar gjymtyra më kryesore e fjalisë, nga e cila varen të gjithë aktantët e përmendur. Të gjitha gjymtyrët e tjera janë konsideruar, të thuash, si satelitë të saj. Kjo është quajtur ndryshe edhe *teori verbocentrike*. Në këtë kontekst, nga ky studiuës mjaft gjerësisht është vështruar edhe çështja e lidhjes së foljes a të foljeve, në përgjithësi, në raport me gjymtyrët e varura, e njohur si valencë e foljeve. Se sa lidhje mund të ketë a të krijojë një folje a një grup i caktuar foljesh në raport me gjymtyrët e tyre të varura (me aktantët e vet), ky studiuës të gjitha foljet i ka ndarë në *jovalente, njëvalente, dyvalente dhe trivalente*, çështje kjo që nuk do të jetë objekt shqyrtimi të trajtës<sup>2</sup>.

Në shkencën e gjuhësisë flitet për dy lloj aktantësh: Për **aktanët obligativë dhe fakultativë**. Këtë lloj klasifikimi a veçimi të aktantëve, me këtë terminologji, nuk e ndeshim në këtë vepër të Tenierit. Por kjo nuk do të thotë se kjo veçori a dualitet i aktantëve ka mbetur si çështje e paprekur. Përkundrazi, kjo çështje aty është zberthyer mjaft mirë, por me shpjegime të tjera gjuhësore.

Për këtë lloj klasifikimi bëjnë fjalë studimet e mëvonshme (kryesisht ato të decenieve të fundit të shekullit që sapo e lamë pas), e në mënyrë të veçantë ato gjermane, angleze frënge etj. Kjo do të thotë se metoda studimore e nisur nga L. Tenieri po trasohet dhe po avansohet me shumë sukses nga pasardhësit e tij në shumë vende të botës. Kështu, fjala vjen, vetëm në gjuhën gjermane janë të njohur studiuësit e gramatikës dependenciale, si: L. M. **Eichinger**, H. **Eroms**, U. **Engel**, G. **Helbig**, R. **Pasch**, K. J. **Saebo**, K. **Welke**, G. **Wotjak**<sup>3</sup>, të cilët janë marrë në mënyrë direkte a indirekte me këtë teori gjuhësore dhe çështje të tjera të kësaj natyre.

Pa hyrë shumë në detaje, (sepse për këtë çështje studimet e gjuhëve të ndryshme janë të shumta dhe akoma po vazhdojnë të bëhen dita - ditës), ne në këtë shkrim do të përpiqem t'i paraqesim shkurtimisht karakteristikat më thelbësore dhe dalluese të aktantëve të përmendur:

**Aktantët obligativë** janë gjymtyrë të domosdoshme të foljeve përkatëse, sepse në ligjërim (me përjashtim të ndonjë ndërtimi mungesor) foljet nuk mund të kryejnë funksion të qartë komunikativ pa to. Me fjalë të tjera, në mes foljes dhe gjymtyrës emërore ekziston një lidhje e fortë rektive, pa të cilën lidhje s' mund të realizohet në masë të duhur një komunikim i qartë në mes folësit dhe bashkëbiseduesit. Shumë shpesh shqipfolësi e fillon ligjërimin e tij konstatues, supozues etj. me foljet si: Unë them... ; unë mendoj... ; Unë e pyeta... ; Unë kërkoj etj. Dhe, nga kjo pikënisje këto folje kërkojnë të kenë një sqarim, elaborim të mëttutjeshëm, një mbështetje në elementet e tjera gjuhësore. Dhe e gjithë kjo realizohet nga aktantët, të cilët janë në shërbim të foljes ftilluese. P. sh.: foljes **them** në ndërtimin e lartpërmendur mund t'i korrespondojnë: ndonjë ndajfolje (si: kështu, ndryshe etj.); ndonjë kundrinë, (si: të kundërtën, të vërtetën); ndonjë togfjalësh, (si: diçka tjetër etj.); dhe, në mënyrë të veçantë, ndonjë fjali të varur kundrinore, (... se çështja duhet të sqarohet mirë e mirë etj. ; Foljes **mendoj** në fjalinë e porsafilluar: një kundrinë e zhdrejtë parafjalore, (si: ... për obligimet/... për të kaluarën tonë/... mbi

<sup>2</sup>Shih më gjerësisht për valencën e foljeve në faqet: 161, 162, 163, 167 etj në veprën e tij të lartpërmendur.

<sup>3</sup>Shih H. Glück, Metzler *Lexikon Sprache*, Stuttgart, 2000, f. 189 - 190 etj.

këtë/ ... mbi ardhmërinë e fëmijëve tanë etj.); një ndajfolje me vlerë rrethore, (si: kështu, / ashtu/ ndryshe; etj), një gjymtyrë e krahasimit (si ju/ si ata); një fjali e varur kundrinore, (... se kjo çështje nuk mund të kryhet edhe aq lehtë /... të them diçka lidhur me këtë çështje) etj. Të gjitha këto njësi brenda kllapave mund të konsiderohen thjesht si aktantë obligativë të foljeve **them dhe mendoj**. Por, edhe foljet e tjera të nënvizuara, në këtë mënyrë, mund të marrin aktantë të këtij lloji.

Në anën tjetër, **aktantët fakultativë** janë ndërtime gjuhësore që nuk i nënshtrohen me çdo kusht foljeve përkatëse. Me fjalë të tjera, lidhja midis foljes si bërthamë kryesore dhe pjesës së varur është mjaft e brishtë. Madje në disa raste foljet e këtilla mund të përdoren edhe pa gjymtyrë plotësuese ose pa aktantë, dhe fjalitë të mos humbin asgjë nga kuptimi. Pra, ato, mund të thuhet, janë të vetëmjaftueshme nga ana semantike e gramatikore. P. sh. me foljet: **punoj, shkoj, eci, iki** etj., mund të formohen fjali të plota e krejtësisht të kuptueshme për folësin a bashkëbiseduesin në gjuhën tonë, si: *Unë po punoj; Unë po shkoj; Unë po iki; por edhe: Unë po punoj në fabrikë; Unë po shkoj në teatër; Unë po iki tani /menjëherë. Pra, gjymtyrët plotësuese: në fabrikë, në teatër, tani / menjëherë etj. mund të konsiderohen si aktantë fakultativë ose si gjymtyrë të domosdoshme.*

Kësaj dysie të aktantëve mund t' i përgjigjet përgjithësisht edhe ky shpjegim: Të gjitha foljet kalimtare mund marrin aktantë obligativë, kurse ato jokalistare, (këtu mund të ketë edhe ndonjë përjashtim për disa trajta foljore, të cilat, ndonëse janë jokalistare, kërkojnë trajta pasuese: pra, kërkojnë aktantë obligativë, si në shembujt: Edhe ti, Genci, zihesh me shokët menjëherë, tha Demka. ; ... u përpoq të ngrihej e të kapte armët dhe dha urdhër t' i gatitnin kalin), marrin përgjithësisht aktantë fakultativë.

Se a do ta marrë folja këtë apo atë aktant, varet nga veçoritë semantike që i ka ajo në një gjuhë të caktuar. Mirëpo, dallimet mund të jenë akoma e më të mëdha (për foljet me kuptim të njëjtë semantik a sinonimik) nga gjuha në gjuhë. Por kjo nuk do të thotë se asnjëherë dhe askund nuk ndeshen pikëpërkime në gjuhë të ndryshme. P. sh. nga një pasqyrë shembujsh të sjellë nga studiuesit Helbig/ Buscha shohim se disa trajta foljore të gjuhës gjermane mund të përkrijnë edhe me shqipen, (p. sh.: gjer. Es blizt / shq. vetëton, si folje pavetore si në gjuhën gjermane, ashtu edhe në gjuhën tonë s' kërkojnë aktantë /Ergänzung/; gjer.: Der Direktor erwartet sein Gäste/shq.: Drejtori pret mysafirët e tij, me dy aktantë obligativë: Der Direktor/Drejtori, si emër në rasën emërore a kryefjalë dhe togfjalëshi: sein Gäste /mysafirët e tij si kundrinë e drejtë; gjer. Das Mädchen wird Lehrerin/shq. Kjo vajzë bëhet mësuese, po ashtu ka dy aktantë obligativë: Das Mädchen/Kjo vajzë, si kryefjalë dhe Lehrerin/ mësuese si përcaktor kallëzuesor; gjer. Daß er kommt, ist bekannt /shq.: Se ai do të vijë, është e njohur; folja këpujore *ist /është* ka aktantët obligativë: bekannt /e njohur si gjymtyrë e kallëzuesit emëror dhe e tërë fjalia e varur ftilluese: Se ai do të vijë/Daß er kommt; gjer. Die Mutter legt das Kind schlafen /shq.: Nëna e çon fëmijën për të fjetur<sup>4</sup>, folja legt/ ka tre aktantë: Die Mutter/Nëna, që është kryefjala e fjalisë; Das Kind/ fëmijën që është kundrina dhe paskajoren *schlafen/ për të fjetur*, me vlerën e rrethorit të qëllimit etj), por pikëdallimet, u mor vesh, janë shumë më të mëdha ndërmjet tyre. P. Sh.: në gjuhën tonë mund të thuhet: Fëmija e

<sup>4</sup>Shih Helbig/Buscha, Deutsche Grammatik, Leipzig, 1999, f. 625 - 629.

ndihmon nënën ose i ndihmon nënës në punët e shtëpisë. Folja ndihmon kërkon patjetër aktantët obligativë: Fëmija, nënën dhe për të punuar. Kurse në gjuhën gjermane thuhet: Das Kind hilft (der Mutter) (arbeiten), çka do të thotë se fjalët në kllapa mund të përdoren a të mos përdoren fare, ngase nuk janë të nevojshme për semantikën e foljes hilft. Pra, Das Kind në emërore, Der Mutter në dhanore dhe arbeiten në paskajore në këtë gjuhë konsiderohen si aktantë fakultativë ose jo të domosdoshëm. Shembuj të tillë kemi mjaft në këtë gjuhë, si: Der Lehrer dankt (dem Schüler) (für die Hilfe); Die Mutter erzählt (den Kindern) (eine Geschichte); Der Arzt antwortet (dem Patienten) (auf seine Frage), (daß er komme)<sup>5</sup> etj. Të gjithë gjymtyrët e fjalisë ose pjesët e fjalisë së përbërë në kllapa në shembujt e kësaj gjuhe mund të konsiderohen si aktantë fakultativë. Ndërsa në gjuhën tonë duhet të merren si aktantë obligativë. Mirëpo, në anën tjetër, folja schreiben e ndonjë tjetër si kjo, ka pothuaj të njëjtën vlerë semantike me atë të gjuhës sonë, si në fjalinë: gjer. Peter schreibt Briefe (shq. Pjetri shkruan letër), meqë folja schreibt/ nuk e kërkon patjetër aktantin Briefe/<sup>6</sup>, ngase kjo folje në të dy gjuhët mund të përdoret edhe pa këtë aktant fare dhe fjalia të mos e humbë kuptimin.

---

<sup>5</sup>Po aty, f. 627 - 628.

<sup>6</sup>Shih Ch. Dürscheid, Syntax, Wiesbaden, 2000, f. 112.